




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
 AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. _____
 Dep. 2-D/DPKI
 Nr. i faq. _____
 Broj stranica 02
 Nr. pages _____

Nr. Prot. _____
 Br. Prot. 01-3728/13
 Prot No. _____
 Data _____
 Datum 05-11-2013
 Date _____

PRISHTINE



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika d) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër korrupsionit me datë 04.11.2013, nxjerr këtë:

V E N D I M

I, Mbyllet rasti me nr. AKK-03-3055/13, për znj. *Bujar Tabaku – Kryeshef në Spitalin rajonal “Isa Grezda” të Gjakovës, për shkak se është parandaluar situata e mundshme e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.*

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti nr. AKK-03-3055-13, i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, për Zyrtarin e lartë, z.Bujar Tabaku – Kryeshef në Spitalit Rajonal “Isa Grezda” Gjakovë, dhe njëkohësisht person i autorizuar në një biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Në rastin me numër protokoli AKK-03-3055/13, të hetuar për ekzistimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, zyrtari i lartë, z.Tabaku së pari është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër korrupsionit pas të cilës ai është paraqitur në Agjencinë kundër korrupsionit, me ç’rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë, për të parandaluar situatën e mundshme të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Zyrtari i lartë, z.Tabaku është deklaruar se do të heq dorë nga të qenurit person i autorizuar i biznesit privat, në mënyrë që të vazhdoi të ushtroj funksionin e tij publik, pa konflikt të interesit.

Ndërkohë, z.Tabaku në Agjenci ka sjellur informacionin zyrtar të lëshuar nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI-03-3636/13), në të cilën shihet se ai ka hequr dorë nga funksioni i personit të autorizuar që kishte të ndërmarrja N.P.Sh.“Dea Med”, për të ushtruar vetëm funksionin e tij zyrtar si Kryeshef në Spitalin Rajonal “Isa Grezda” të Gjakovës.


II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Drejtore i Agjencisë kundër korrupsionit



The image shows a circular official stamp of the Agency for the Fight Against Corruption (AKK-RKS) in Kosovo. The stamp contains the text: 'REPUBLIKA E KOSOVES', 'AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT', 'AGENCY AGAINST CORRUPTION', 'REPUBLIKA KOSOVA', and 'REPUBLIC OF KOSOVA'. A handwritten signature in blue ink is written over the stamp.